QKB

| AKT THEMELIMI<br>I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR<br>WE ARE FIBER Sh.p.k. | ATTO COSTITUTIVO<br>DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA<br>WE ARE FIBER SH.P.K. |
|---|---|
| - Shoqëria C.P.O. S.R.L me numër identifikimi P.iva 08606711219, seli Acerra (NA), Via A. Pacinotti 10, Cap 80011, Italy përfaqësuar nga Francesco Marotta.<br>- Shoqëria Fiber Group Shpk me NUIS L52519403R, seli FIER, Lagjja "Apollonia", Rruga "Jakov Xoxa", pallati nr.11, kodi postar nr.9302, përfaqësuar nga Daniele Volpe | - La societa C.P.O. S.R.L, con P.iva 08606711219, sede Acerra (NA), Via A. Pacinotti 10, Cap 80011, Italy, rapresentata dal Signor Francesco Marotta.<br>- La societa Fiber Group Shpk, con NUIS L52519403R, sede FIER, Lagjja "Apollonia", Rruga "Jakov Xoxa", pallati nr.11, kodi postar nr.9302, rapresentata dal Daniele Volpe. |
| kemi vendosur të nënshkruajmë Aktin e Themelimin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti. | abbiamo deciso di stipulare il seguente Atto Costitutivo di una società a responsabilità limitata, (di seguito "**Società**") la cui attività verrà regolata dalla legislazione Albanese in vigore e dal suo Statuto che fa parte integrante di questo atto. |
| **Neni 1 - Emërtimi** | **Art. 1 - Denominazione** |
| Emërtimi i Shoqërisë është **WE ARE FIBER** Sh.p.k. | La denominazione della Società è **WE ARE FIBER** Sh.p.k. |
| **Neni 2 - Selia** | **Art. 2 - Sede** |
| Selia e Shoqërisë është në Lagja Apollonia, Rruga Jakov Milaj, Pall 24, 9303, Fier, Shqiperi. | La sede legale della Società è stabilita in Lagja Apollonia, Rruga Jakov Milaj, Pall 24, 9303, Fier, Shqiperi. |
| **Neni 3 - Kohëzgjatja** | **Art. 3 - Durata** |
| Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat deri në 31/12/2060 por mund të shtyhet ose prishet parakohe me vendim të asamblesë së ortakëve. | La durata della Società è stabilita fino al 31/12/2060 ma potrà essere prorogata o sciolta anticipatamente con deliberazione dell'assemblea dei soci. |
| **Neni 4 – Objekti i shoqërisë** | **Art. 4 – Oggetto sociale** |
| 4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe:<br>- menaxhimin e qendrave të përpunimit të të dhënave në emër të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;<br>- ofrimin e shërbimeve për bizneset në fushat financiare, kontabilitetin e përgjithshëm dhe atë industrial, të organizimit, të inovacionit teknologjik dhe rregullator;<br>- ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve të | 4.1 La Società ha come oggetto sociale lo svolgimento delle attività commerciali in conformità con la legislazione albanese in vigore e:<br>- la gestione di centri per elaborazione dei dati per conto di piccole e medie imprese;<br>- la prestazione di servizi alle imprese nei campi finanziari, della contabilità generale ed industriale, della organizzazione, della innovazione tecnologica e normative;<br>- la prestazione e la fornitura di servizi aziendali nel campo della comunicazione e |

| | |
|---|---|
| shoqërive në fushën e komunikimit dhe telekomunikacionit – të telefonisë së lëvizshme, fikse, të lëvizshme për shërbimet e të dhënave për shoqëri, institucione publike, dhe private, në Shqipëri dhe jashtë vendit, gjithashtu me teknologji inovative elektrike dhe telematike; | telecomunicazione - telefonia mobile, fissa, mobile per servizi dati ed internate ad imprese, enti pubblici e privati, in Albania e all'estero anche con tecnologie innovative elettriche e telematiche; |
| - veprimtari të konsulencës dhe asistencës dhe të shërbimeve reale për kompanitë; | - l'attività di consulenza ed assistenza e di servizi reali alle imprese; |
| - shitjen dhe ofrimin e shërbimeve të administrimi kompanie për bizneset, subjektet publike dhe private; organizimi i takimeve, konferencave, ngjarjeve, reklamave dhe aktiviteteve promovuese në emër të kompanive, organeve publike dhe private, hulumtimit të tregut dhe analizës së sektorit në favor të bizneseve, institucioneve publike dhe private; tregti me pakicë dhe me shumicë të lebaratorëve elektronikë, software, hardware, programeve, pajisjeve dhe aplikimeve të çdo natyre relative dhe sidomos lidhur me komunikimet dhe telekomunikacionin, makiner dhe pajisjet përkatëse për përpunimin e të dhënave në territorin kombëtar si dhe në atë të huaj, si dhe asistencën dhe mirëmbajtjen e tyre; sigurimi i shërbimeve promocionale dhe shitja ose dhënia me qira e hapësirës reklamuese në sistemet e rrjetit, dhe në përgjithësi çdo veprimtari tjetër që lidhet me kompjuterët dhe përpunimin e të dhënave; | - la vendita e la prestazione di servizi aziendali ad imprese, enti pubblici e privati; organizzazioni di meeting, conferenze, manifestazioni, attività pubblicitarie e promozionali per conto di imprese, enti pubblici e private, ricerche di mercato ed analisi di settore in favore di imprese, enti pubblici e privati; commercio al dettaglio ed all'ingrosso di elaboratori elettronici, software, hardware, programmi, apparecchiature ed applicazioni di qualsivoglia natura relativi e comunque connessi con le comunicazioni e telecomunicazione, macchinari ed accessori relativi all'elaborazione dei dati sia sul territorio nazionale che all'estero, nonché la loro assistenza e manutenzione; fornitura di servizi promozionali e vendita o noleggio di spazi pubblicitari su sistemi di rete, ed in generale qualsiasi altra attività correlata ai computer ed all'elaborazione dei dati; |
| - shërbimet e organizimit të biznesit lidhur me çështjet e menaxhimit, marketingut, shpërndarjes dhe depërtimit tregtar, si dhe për menaxhimin ekonomik-financiar, administrative-kontabile për zgjedhjen, menaxhimin, përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit; | - servizi di organizzazione aziendale relativi alle problematiche di gestione, di marketing, della distribuzione e della penetrazione commerciale, nonché alle problematiche economico-finanziarie, amministrativo - contabili di selezione, gestione, selezione e formazione del personale; |
| - ofrimin e shërbimeve për të mbështetur aktivitetet prodhuese, industriale, komerciale, artizanale, bujqësore, turistike dhe shërbimi, duke pasur parasysh në veçanti furnizimin e shërbimeve të IT-së duke përfshirë përpunimin e të dhënave në emër të palëve të treta dhe krijimin e softuerit aplikativ, marrjen, mbledhjen, kodimin, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve, shërbimet organizative teknike-ekonomike përfshirë studimet e fizibilitetit; | - fornitura di servizi destinati al sostegno delle attività produttive, industriali, commerciali, artigiane, agricole, turistiche e di servizi, con particolare riguardo alla fornitura di servizi di informatica incluse l'elaborazione dei dati per conto di terzi e la realizzazione di software applicativo, acquisizione, raccolta, codificazione, gestione ed elaborazione di dati, informazioni e documenti, servizi di organizzazione tecnico-economica inclusi studi di fattibilità; |
| - marrjen mandatit të agjencisë dhe / ose mandateve përfaqësuese, me ose pa depozita, | - l'assunzione di mandati di agenzia e/o di rappresentanza, con o senza deposito, per la commercializzazione di servizi, di beni materiali ed immateriali, di apparecchiature ed |

për tregtimin e shërbimeve, mjeteve materiale dhe jo materiale, pajisjeve dhe aplikimeve të çfarëdo lloji që kanë të bëjnë me dhe në çdo rast të lidhura me komunikimet dhe softuerin e telekomunikacionit hardware dhe aksesorëve;
- Në lidhje me këtë objekt, kompania do të jetë në gjendje të kryejë të gjitha transaksionet tregtare, industriale, financiare, të pasurive të patundshme dhe luajtëshme që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit në vetvete;
- Në veçanti, kompania do të jetë në gjendje të ofrojë garanci, në përgjithësi për të veten dhe për palët e treta për të garantuar financimin, hipotekat dhe çdo transaksion financiar, shoqëria do të jetë në gjendje të marrë financim nga aksionarët në përputhje me ligjin.
- Shoqëria mund të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë si dhe të tërthortë, pjesmarrje në kompani të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose të lidhur me të, jo për qëllimin e vendosjes por për investim të qëndrueshëm, brenda kufijve të lejuar nga ligji.
- Shoqëria gjithashtu do të jetë në gjendje të kryejë çdo aktivitet plotësues, të lidhur me ato të sipërcituara brenda kufijve të ligjit.

### Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **10,000 (dhjetëmijë) Euro** i cili nuk është i paguar.

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.

### Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Shoqërisë C.P.O. S.R.L, i përket një kuotë, me vlere nominale 3,300 (tremijëetreqind) Euro që i korrespondon 33% të kapitalit të Shoqërisë;
- Shoqërisë Fiber Group Shpk, i përket një kuotë, me vlere nominale 6,700 (gjashtëmijëeshtatëqind) Euro që i

applicazioni di qualsivoglia natura relativi e comunque connessi con le comunicazioni e telecomunicazioni, di software hardware e accessori;
- in relazione a tale oggetto, la società' potrà' compiere tutte le operazioni commerciali, industriali, finanziarie, immobiliari, mobiliari che saranno ritenute necessarie od utili per il conseguimento del oggetto medesimo;
- La società' potrà' in particolare prestare fideiussioni, avalli e garanzie in genere a favore proprio e di terzi per garantire finanziamenti, mutui e qualsiasi operazione finanziaria, la società' potrà' assumere finanziamenti dai soci nel rispetto della legge;
- La società' potrà' infine, assumere, sia direttamente che indirettamente, a partecipazioni in altre società' od imprese aventi oggetto analogo od affine o comunque connesso al proprio, non a scopo di collocamento ma di investimento stabile, nei limiti consentiti dalla legge;
- La società' inoltre potrà' svolgere ogni e qualsiasi attività' complementare, affine o connessa con le precedenti nei limiti di legge;

### Art. 5 - Capitale sociale

5.1. Il capitale sociale è di **10,000 (diecimila)** Euro il quale non e stato pagato.

5.2. Il capitale sociale è composto da 2 (due) quote, aventе il valore nominale come da conferimento dei soci nel capitale sociale della Societa' indicato all'art. 6 (sei) di questo Atto.

### Art. 6 - Conferimenti e quote

6.1 Il conferimento del capitale sociale e nel modo seguente:

- Alla Società C.P.O. S.R.L, appartiene una quota, avente valore nominale pari a Euro 3,300 (tremila e trecento) che corrisponde a 33% del capitale della Società;
- Alla Società Fiber Group Shpk, appartiene una quota, avente valore nominale pari a Euro 6,700 (seimila e settecento) che corrisponde a 67% del

korrespondon 67% të kapitalit të Shoqërisë.

### Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

### Neni 8 – Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- **Z. Daniele Volpe,** lindur më 13.01.1984, shtetas Italian, me pasaportë nr. YA9834482, cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjtha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

### Neni 9– Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane.

9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në italisht do të jetë i vetmi

capitale della Società;

### Art. 7 – Trasferibilità delle quote

Le quote sociali saranno trasferibili a terzi secondo le modalità previste dallo Statuto.

### Art. 8 – Amministrazione

8.1 Con il presente atto viene nominato 1 (uno) Amministratore della Società come segue:

- **Sig. Daniele Volpe,** nato il 13.01.1984, cittadino Italiano, con passaporto n. YA9834482, che è nominato per un periodo di 5 (cinque) anni.

8.2 L'Amministratore potrà esercitare tutti i poteri di ordinaria amministrazione, in conformità con quanto previsto dall'articolo 95 della legge n. 9901 "Sui Commercianti e le Società Commerciali", del 14 aprile 2008 ed all'art. 14 dello Statuto.

8.3 All'Amministratore vengono conferiti tutti i poteri necessari per svolgere tutte le formalità e gli adempimenti previsti per la costituzione della Società secondo la legislazione e la normativa vigente. A tal fine, l'Amministratore potrà avvalersi dell'ausilio di terzi e di consulenti ai quali potrà delegare in parte o in tutto lo svolgimento delle suddette attività.

8.4 L'Amministratore è altresì autorizzato ad agire in nome e per conto della costituenda Società fino alla sua registrazione presso il Centro Nazionale di Registrazione delle Imprese. L'Amministratore è autorizzato a firmare tutti gli atti ed a contrarre in nome della Società gli obblighi insorgenti dal momento della sua registrazione presso il Centro Nazionale di Registrazione stesso ed a delegare i suoi poteri anche ad altri procuratori speciali.

### Art. 9 – Lingua

9.1 Il presente Atto Costitutivo è redatto in 4 (quattro) copie in lingua albanese e in lingua italiana.

9.2 Per tutte le controversie che dovessero insorgere relativamente all'interpretazione dei predetti atti e documenti, la versione italiana

version ligjërisht detyrues.

**Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

**ORTAKËT**

**Shoqëria C.P.O. S.R.L**
Përfaqësuar nga
Francesco Marotta

**Shoqëria Fiber Group Shpk**
Përfaqësuar nga
Daniele Volpe

PERKTHYES

sarà l'unica legalmente vincolante.

**Art. 10 - Composizione delle controversie**

10.1 Tutte le controversie che dovessero insorgere circa l'interpretazione, applicazione e risoluzione del presente statuto della Società e in genere quelle che dovessero insorgere tra i soci (tranne quelle inerenti a rapporti personali o extra societari) oppure tra uno o più soci e la società verranno in linea di principio amichevolmente e direttamente discusse tra gli interessati.

10.2 In caso di mancata composizione amichevolmente, la soluzione sarà affidata al Tribunale di Tirana.

**IL SOCI**

**La società C.P.O. S.R.L**
Rappresentata da
Francesco Marotta

**La società Fiber Group Shpk**
Rappresentata da
Daniele Volpe

INTERPRETE

**STATUTI**
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**WE ARE FIBER Sh.p.k.**

Në këtë statut
"Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
"Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Themeluesi i shoqërisë është:

- Shoqëria C.P.O. S.R.L me numër identifikimi P.iva 08606711219, seli Acerra (NA), Via A. Pacinotti 10, Cap 80011, Italy përfaqësuar nga Francesco Marotta.
- Shoqëria Fiber Group Shpk me NUIS L52519403R, seli FIER, Lagjja "Apollonia", Rruga "Jakov Xoxa", pallati nr.11, kodi postar nr.9302, përfaqësuar nga Daniele Volpe

**KAPITULLI I**
**FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

1.1. Shoqëria WE ARE FIBER Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.

1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

1.3. Statuti i shoqerise është ne përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në te, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është WE ARE FIBER Sh.p.k.

**STATUTO**
**DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA**
**WE ARE FIBER SH.P.K.**

In questo statuto
"Legge" è la legge n. 9901, dt. 14.04.2008 "Commercianti e le aziende";
"Statuto" è lo Statuto della Società;

Il fondatore dell'azienda è:

- La societa C.P.O. S.R.L, con P.iva 08606711219, sede Acerra (NA), Via A. Pacinotti 10, Cap 80011, Italy, rapresentata dal Signor Francesco Marotta.
- La societa Fiber Group Shpk, con NUIS L52519403R, sede FIER, Lagjja "Apollonia", Rruga "Jakov Xoxa", pallati nr.11, kodi postar nr.9302, rapresentata dal Daniele Volpe.

**CAPITOLO I**
**FORMA, DENOMINAZIONE, OGGETTO, SEDE, DURATA.**

**Art. 1 – Forma**

1.1. La Società WE ARE FIBER Sh.p.k. (d'ora in avanti la "**Società**") è costituita in forma di società a responsabilità limitata, ed è regolata dal presente Statuto.

1.2. La Società opera secondo la legislazione albanese in vigore.

1.3. Lo Statuto della Società e' conforme alla normativa albanese a carattere inderogabile ed e' integrato, per quanto in essi non espressamente previsto, dalla legislazione albanese.

**Art. 2 - Denominazione**

La denominazione della Società è WE ARE FIBER Sh.p.k.

| Neni 3 – Objekti i shoqërisë | Art. 3 – Oggetto sociale |
|---|---|
| 3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe: | 3.1 La Società ha come oggetto sociale lo svolgimento delle attività commerciali in conformità con la legislazione albanese in vigore e: |
| - menaxhimin e qendrave të përpunimit të të dhënave në emër të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; | - la gestione di centri per elaborazione dei dati per conto di piccole e medie imprese; |
| - ofrimin e shërbimeve për bizneset në fushat financiare, kontabilitetin e përgjithshëm dhe atë industrial, të organizimit, të inovacionit teknologjik dhe rregullator; | - la prestazione di servizi alle imprese nei campi finanziari, della contabilità generale ed industriale, della organizzazione, della innovazione tecnologica e normative; |
| - ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve të shoqërive në fushën e komunikimit dhe telekomunikacionit – të telefonisë së lëvizshme, fikse, të lëvizshme për shërbimet e të dhënave për shoqëri, institucione publike, dhe private, në Shqipëri dhe jashtë vendit, gjithashtu me teknologji inovative elektrike dhe telematike; | - la prestazione e la fornitura di servizi aziendali nel campo della comunicazione e telecomunicazione - telefonia mobile, fissa, mobile per servizi dati ed internate ad imprese, enti pubblici e privati, in Albania e all'estero anche con tecnologie innovative elettriche e telematiche; |
| - veprimtari të konsulencës dhe asistencës dhe të shërbimeve reale për kompanitë; | - l'attività di consulenza ed assistenza e di servizi reali alle imprese; |
| - shitjen dhe ofrimin e shërbimeve të administrimi kompanie për bizneset, subjektet publike dhe private; organizimi i takimeve, konferencave, ngjarjeve, reklamave dhe aktiviteteve promovuese në emër të kompanive, organeve publike dhe private, hulumtimit të tregut dhe analizës së sektorit në favor të bizneseve, institucioneve publike dhe private; tregti me pakicë dhe me shumicë të lebaratorëve elektronikë, software, hardware, programeve, pajisjeve dhe aplikimeve të çdo natyre relative dhe sidomos lidhur me komunikimet dhe telekomunikacionin, makiner dhe pajisjet përkatëse për përpunimin e të dhënave në territorin kombëtar si dhe në atë të huaj, si dhe asistencën dhe mirëmbajtjen e tyre; sigurimi i shërbimeve promocionale dhe shitja ose dhënia me qira e hapësirës reklamuese në sistemet e rrjetit, dhe në përgjithësi çdo veprimtari tjetër që lidhet me kompjuterët dhe përpunimin e të dhënave; | - la vendita e la prestazione di servizi aziendali ad imprese, enti pubblici e privati; organizzazioni di meeting, conferenze, manifestazioni, attività pubblicitarie e promozionali per conto di imprese, enti pubblici e private, ricerche di mercato ed analisi di settore in favore di imprese, enti pubblici e privati; commercio al dettaglio ed all'ingrosso di elaboratori elettronici, software, hardware, programmi, apparecchiature ed applicazioni di qualsivoglia natura relativi e comunque connessi con le comunicazioni e telecomunicazione, macchinari ed accessori relativi all'elaborazione dei dati sia sul territorio nazionale che all'estero, nonché la loro assistenza e manutenzione; fornitura di servizi promozionali e vendita o noleggio di spazi pubblicitari su sistemi di rete, ed in generale qualsiasi altra attività correlata ai computer ed all'elaborazione dei dati; |
| - shërbimet e organizimit të biznesit lidhur me çështjet e menaxhimit, marketingut, shpërndarjes dhe depërtimit tregtar, si dhe për | - servizi di organizzazione aziendale relativi alle problematiche di gestione, di marketing, della distribuzione e della penetrazione commerciale, nonché alle |

menaxhimin ekonomik-financiar, administrative-kontabile për zgjedhjen, menaxhimin, përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit;
- ofrimin e shërbimeve për të mbështetur aktivitetet prodhuese, industriale, komerciale, artizanale, bujqësore, turistike dhe shërbimi, duke pasur parasysh në veçanti furnizimin e shërbimeve të IT-së duke përfshirë përpunimin e të dhënave në emër të palëve të treta dhe krijimin e softuerit aplikativ, marrjen, mbledhjen, kodimin, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve, shërbimet organizative teknike-ekonomike përfshirë studimet e fizibilitetit;
- marrjen mandatit të agjencisë dhe / ose mandateve përfaqësuese, me ose pa depozita, për tregtimin e shërbimeve, mjeteve materiale dhe jo materiale, pajisjeve dhe aplikimeve të çfarëdo lloji që kanë të bëjnë me dhe në çdo rast të lidhura me komunikimet dhe softuerin e telekomunikacionit hardware dhe aksesorëve;
- Në lidhje me këtë objekt, kompania do të jetë në gjendje të kryejë të gjitha transaksionet tregtare, industriale, financiare, të pasurive të patundshme dhe luajtëshme që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit në vetvete;
- Në veçanti, kompania do të jetë në gjendje të ofrojë garanci, në përgjithësi për të veten dhe për palët e treta për të garantuar financimin, hipotekat dhe çdo transaksion financiar, shoqëria do të jetë në gjendje të marrë financim nga aksionarët në përputhje me ligjin.
- Shoqëria mund të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë si dhe të tërthortë, pjesmarrje në kompani të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose të lidhur me të, jo për qëllimin e vendosjes por për investim të qëndrueshëm, brenda kufijve të lejuar nga ligji.
- Shoqëria gjithashtu do të jetë në gjendje të kryejë çdo aktivitet plotësues, të lidhur me ato të sipërcituara brenda kufijve të ligjit

problematiche economico-finanziarie, amministrativo - contabili di selezione, gestione, selezione e formazione del personale;
- fornitura di servizi destinati al sostegno delle attività produttive, industriali, commerciali, artigiane, agricole, turistiche e di servizi, con particolare riguardo alla fornitura di servizi di informatica incluse l'elaborazione dei dati per conto di terzi e la realizzazione di software applicativo, acquisizione, raccolta, codificazione, gestione ed elaborazione di dati, informazioni e documenti, servizi di organizzazione tecnico-economica inclusi studi di fattibilità;
- l'assunzione di mandati di agenzia e/o di rappresentanza, con o senza deposito, per la commercializzazione di servizi, di beni materiali ed immateriali, di apparecchiature ed applicazioni di qualsivoglia natura relativi e comunque connessi con le comunicazioni e telecomunicazioni, di software hardware e accessori;
- in relazione a tale oggetto, la società' potrà' compiere tutte le operazioni commerciali, industriali, finanziarie, immobiliari, mobiliari che saranno ritenute necessarie od utili per il conseguimento del oggetto medesimo;
- La società' potrà' in particolare prestare fideiussioni, avalli e garanzie in genere a favore proprio e di terzi per garantire finanziamenti, mutui e qualsiasi operazione finanziaria, la società' potrà' assumere finanziamenti dai soci nel rispetto della legge;
- La società' potrà' infine, assumere, sia direttamente che indirettamente, a partecipazioni in altre società' od imprese aventi oggetto analogo od affine o comunque connesso al proprio, non a scopo di collocamento ma di investimento stabile, nei limiti consentiti dalla legge;
- La società' inoltre potrà' svolgere ogni e qualsiasi attività' complementare, affine o connessa con le precedenti nei limiti di legge;

| | |
|---|---|
| **Neni 4 - Selia** | **Art. 4 - Sede** |
| 4.1 Selia e Shoqërisë është në Lagja Apollonia, Rruga Jakov Milaj, Pall 24, 9303, Fier, Shqiperi. | 4.1 La sede legale della Società è stabilita in Lagja Apollonia, Rruga Jakov Milaj, Pall 24, 9303, Fier, Shqiperi. |
| 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. | 4.2 Il trasferimento della sede della Società in un altro luogo avverrà con la deliberazione dell'Assemblea dei soci. |
| 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë edhe jashte Shqiperie. | 4.3. L'Assemblea dei soci potrà decidere l'apertura di filiali, rami e rappresentanze in altre città dell'Albania ed anche all'estero. |
| **Neni 5 - Kohëzgjatja e veprimtarisë** | **Art. 5 - Durata** |
| 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat deri në 31/12/2060. | 5.1. La durata della Società è stabilita fino al 31/12/2060. |
| 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve. | 5.2 La Società potrà essere sciolta anticipatamente per deliberazione dell'Assemblea dei soci. |
| **KAPITULLI II**<br>**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE** | **CAPITOLO II**<br>**CAPITALE SOCIALE, CONFERIMENTI, RIPARTIZIONE DELLE QUOTE SOCIALI E TRASFERIBILITA' DELLE QUOTE** |
| **Neni 6 - Kapitali themeltar** | **Art. 6 - Capitale sociale** |
| 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është është 10,000 (dhjetëmijë) Euro i cili nuk është i paguar. | 6.1. Il capitale sociale è di 10,000 (diecimila) Euro il quale non e stato pagato. |
| 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 3 kuota, e gjitha e nënshkruar, me vlerë nominale sipas kontributit të secilit ortak ne kapitalin themeltar te Shoqërisë percaktuar ne nenin 7 (shtate) te ketij Statuti. | 6.2. Il capitale sociale è composto da 3 quota interamente sottoscritta, avente il valore nominale come da conferimento dei soci nel capitale sociale della Società indicato all'art. 7 (sette) di questo Statuto. |
| **Neni 7 - Kontributet** | **Art. 7 - Conferimenti e quote** |
| 7.1 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre te mëposhtme: | 7.1 La partecipazione dei fondatori nel capitale della società è conforme ai seguenti contributi: |
| - Shoqërisë C.P.O. S.R.L, i përket një kuotë, me vlere nominale 3,300 (tremijëetreqind) Euro që i | - Alla Società C.P.O. S.R.L, appartiene una quota, avente valore nominale pari a Euro 3,300 (tremila e trecento) che corrisponde a 33% del capitale della |

korrespondon 33% të kapitalit të Shoqërisë;
- Shoqërisë Fiber Group Shpk, i përket një kuotë, me vlere nominale 6,700 (gjashtëmijëeshtatëqind) Euro që i korrespondon 67% të kapitalit të Shoqërisë.

**Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me vleren nominale te kuotes se kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me vleren nominale te kuotes se kapitalit të zotëruar prej tyre.

**Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vleren nominale te kuotes se kapitalit të zotëruar prej tyre.

**Neni 10 – Transferimi i kuotave**

10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.

Società;
- Alla Società Fiber Group Shpk, appartiene una quota, avente valore nominale pari a Euro 6,700 (seimila e settecento) che corrisponde a 67% del capitale della Società;

**Art. 8 - Aumenti del capitale sociale**

8.1. Il capitale sociale potrà essere aumentato senza limiti in qualsiasi momento in una o più volte, con la deliberazione dell'Assemblea dei soci.

8.2. In caso di deliberazione di aumento del capitale sociale, tutti i soci hanno diritto di sottoscrivere l'aumento stesso in proporzione al valore nominale della quota di capitale posseduta. Nel caso non esercitino questo diritto le loro quote potranno essere sottoscritte dagli altri soci proporzionalmente al valore nominale della quota di capitale posseduta.

**Art. 9 - Riduzione del capitale sociale**

9.1. La Società può ridurre il capitale sociale previa deliberazione dell'Assemblea dei soci. In ogni caso il capitale sociale non può essere ridotto sotto il minimo previsto dalla legge.

9.2. La riduzione del capitale è sopportata da ciascun socio proporzionalmente al valore nominale della quota di capitale posseduta.

**Art. 10 - Trasferibilità delle quote**

10.1 Le quote sono liberamente trasferibili tra i soci.

10.2 In caso di cessione a qualsiasi titolo, sia oneroso sia gratuito nella più ampia accezione del termine, compresa quindi la donazione delle quote sociali a soggetti diversi dai soci, le quote devono essere offerte in prelazione agli altri soci.

| | |
|---|---|
| 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjithe kuotes të ofruar për shitje. | 10.3 In tal caso il socio alienante dovrà comunicare per iscritto agli altri soci, mediante lettera raccomandata a/r, la volontà di vendere, con l'indicazione del prezzo, condizioni, modalità, nome dell'acquirente e termini della cessione. Il diritto di prelazione dovrà comunque riferirsi alla intera quota offerta in vendita. |
| 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes. | 10.4 I soci avranno 15 (quindici) giorni, dal ricevimento della lettera raccomandata a/r, per comunicare al socio alienante la loro eventuale volontà di esercitare o no il diritto di prelazione. Alla scadenza del termine stabilito, il diritto di prelazione a loro favore si intende rinunciato. |
| 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon ate, do të ndahet midis ortakëve pranues, në të njëjtën masë me vleren nominale te kuotes se kapitalit qe ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes. | 10.5 Nel caso in cui l'offerta sia accettata da più soci, la quota del socio alienante sarà suddivisa tra gli accettanti in misura proporzionale al valore nominale della quota di capitale da ciascuno di essi posseduta, salvo diverso accordo tra le parti. In nessun caso l'offerente sarà tenuto ad accettare un esercizio soltanto parziale del diritto di prelazione. |
| 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, pas miratimit të Asamblesë së Ortakëve. | 10.6 In caso di mancato esercizio del diritto di prelazione, le quote potranno essere trasferite a terzi in tutto o in parte, previa approvazione dell'Assemblea dei soci. |
| **KAPITULLI III<br>ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL** | **CAPITOLO III<br>ASSEMBLEA, AMMINISTRATORI ED ESPERTO CONTABILE** |
| **Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj** | **Art. 11 - Assemblea dei soci e relativi poteri** |
| 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. | 11.1. L'organo decisionale della Società è l'Assemblea dei soci |
| 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e satutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i | 11.2. All'Assemblea dei soci competono le decisioni riguardanti le seguenti materie: la modifica dello statuto, nomina e revoca degli amministratori, degli esperti contabili e dei liquidatori, l'aumento, diminuzione del |

kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.

**Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota ne proporcion me vleren nominale te kuotes se kapitalit që ai zotëron.

12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

**Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet**

13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.

13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet e-mail, njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton sipas ketij Statuti – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

capitale sociale, trasferimento quote, distribuzione dell'utile, riorganizzazione e scioglimento della società, approvazione del bilancio e quant'altro previsto dal presente Statuto e dalla legge di riferimento.

**Art. 12 – Diritti di partecipazione e di voto**

12.1. Ogni socio ha il diritto di partecipare alle assemblee, di far presente la propria opinione e di esprimere tanti voti in proporzione al valore nominale della quota di capitale posseduta.

12.2. Ogni socio ha il diritto di farsi rappresentare da altra persona, anche non socio, munita di semplice procura scritta, attraverso il quale potrà esprimere il proprio voto.

12.3. Il socio non può conferire alcuna procura di voto per una parte del suo capitale, se vota di persona per la restante parte.

**Art. 13 - Convocazione di Assemblea, quorum e delibere**

13.1 L'Assemblea deve essere convocata almeno una volta all'anno entro 6 mesi dalla chiusura dell'esercizio per l'approvazione del bilancio, delle relazioni degli Amministratori e/o dell'esperto contabile, oltre che dell'inventario.

13.2 L'Assemblea può inoltre essere convocata in qualsiasi momento da uno degli Amministratori oltre che da uno o più soci che rappresentino almeno 5% (cinque per cento) del capitale sociale. L'Assemblea deve essere convocata a mezza di e-mail, lettera raccomandata con ricevuta di ritorno fatta pervenire ai soci - nel domicilio risultante dal presente Statuto – ed all'esperto contabile (se nominato) almeno 7 (sette) giorni prima del giorno fissato per l'Assemblea. La convocazione deve contenere l'indicazione del tipo di Assemblea, delle materie da trattare e da deliberare, del luogo, ora e data della

| | |
|---|---|
| | prima e della seconda convocazione. |
| 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë. | 13.3 L'Assemblea può essere convocata anche fuori dalla sede sociale. |
| 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 te këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite. | 13.4 In caso di mancata riunione dell'Assemblea nella prima convocazione per mancanza del quorum previsto nel paragrafo 13.7 del presente statuto, l'Assemblea vera' convocata entro 30 giorni con lo stesso ordine del giorno. |
| 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çeshtjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes. | 13.5 E' ammessa la possibilità che le riunioni dell'Assemblea si tengano per teleconferenza e videoconferenza, a condizione che tutti i partecipanti possano essere identificati e sia loro consentito di seguire la discussione e intervenire in tempo reale alla trattazione degli argomenti affrontati; verificandosi questi requisiti, che dovranno risultare dal verbale di adunanza, l'Assemblea si considera tenuto nel luogo in cui si trova il Presidente e dove pure deve trovarsi il Segretario della riunione. |
| 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar. | 13.6 L'Assemblea si riterrà regolarmente convocata e costituita anche senza il rispetto delle formalità di convocazione, se é presente o rappresentato l'intero capitale sociale. |
| 13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 51% të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 70% të kapitalit themeltar. | 13.7 Le deliberazioni dell'Assemblea dei soci, le quali richiedono una maggioranza semplice, sono valide se sono presenti i soci con diritto di voto che rappresentano più del 70% dell'intero capitale sociale. Le deliberazioni dell'Assemblea dei soci, le quali richiedono una maggioranza qualificata, sono valide se sono presenti i soci con diritto di voto che rappresentano almeno il 70% (settanta percento) dell'intero capitale sociale. |
| 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e satutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të ¾ (tre të katërtat) e ortakëve te pranishëm që zotërojnë të paktën 70% të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, | 13.8 L'Assemblea delibera la modificazione dello statuto, l'aumento e diminuzione del capitale registrato, la distribuzione dell'utile la riorganizzazione e lo scioglimento della società con il voto favorevole dei soci rappresentanti almeno i ¾ (tre quarti) dei soci presenti, che rappresentano almeno il 70% dell'intero capitale sociale. In tutti gli altri casi, |

Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë më shumë se 51% të kapitalit themeltar.

13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

**Neni 14 - Administrimi**

14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje për një periudhë prej 5 (pese) vitesh.

14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtroj të gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*".

14.3 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

14.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqerisë:

- **Z. Daniele Volpe,** lindur më 13.01.1984, shtetas Italian, me pasaportë nr. YA9834482, cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Nënshkrimi i administratorit

DANIELE VOLPE

**Neni 15 - Eksperti kontabël i autorizuar**

15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i

l'Assemblea dei soci delibera in seduta ordinaria con la maggioranza semplice dei voti dei soci presenti, che rappresentano più del 51% dell'intero capitale sociale.

13.9 Ogni Assemblea è presieduta da un socio o altra persona designata dalla stessa Assemblea. Per la verbalizzazione, l'Assemblea nomina un Segretario, anche non socio.

13.10 Le deliberazioni dell'Assemblea devono essere sottoscritte dal Presidente dell'Assemblea e dal Segretario.

**Art. 14 - Amministrazione**

14.1 La Società è amministrata da almeno 1 (uno) Amministratore, il quale rimane in carica fino a revoca o dimissioni ovvero per un periodo di 5 (cinque) anni.

14.2 La rappresentanza legale della Società spetta all'Amministratore. L'Amministratore potrà esercitare tutti i poteri in conformità con quanto previsto dall'articolo 95 della legge n. 9901 del 14.04.2008 "*Per i Commercianti e le Società Commerciali*".

14.3 L'Amministratore può nominare procuratori speciali per singoli atti o categorie di atti.

14.4 La seguente persona viene nominata come primo amministratore della società:

